



**Prishtinë, 28 dhjetor 2012**  
**Kodi i ZRRE-së: V\_492\_2012**

## **Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji**

### **Duke u bazuar në:**

- Nenin 8 paragrafi 1 nënparagrafi 1.6, nenin 14 paragrafi 2 nënparagrafi 1.7 dhe nenin 25 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L-185);
- Nenin 4, 5 dhe 13 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Kapaciteteve të reja; dhe
- Aplikacionin për Autorizim për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga uji, në Lumin Drini i Bardhë, të tipit digë, me kapacitet të instaluar prej 9.9 MW, në lokacionin e fshatit Dobrushtë, komuna e Prizrenit, të datës 14.03.2012 të ndërmarrjes “Drini i Bardhë” SH.A., me adresë rruga “Vetim Shala” nr. 4, KK Prizren, Republika e Kosovës,

**në seancën e mbajtur me datë 28 dhjetor 2012 nxori këtë:**

## **V E N D I M**

### **Mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar**

- I.** Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) konstaton se ndërmarrja “Drini i Bardhë” SH.A., ka dëshmuar përshtatshmërinë për zhvillimin e projektit për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese nga uji, në Lumin Drini i Bardhë, të tipit digë, me kapacitet të instaluar prej 9.9 MW, në lokacionin e fshatit Dobrushtë, komuna e Prizrenit.
- II.** Aplikantit “Drini i Bardhë” SH.A., mund t’i lëshohet **AUTORIZIMI** për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, pas përmbushjes së kërkesave që dalin nga Nenet 14 dhe 15 të Rregullës për Procedurën e Autorizimit dhe kërkesave tjera të legjislacionit tjetër të aplikueshëm lidhur me ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese.
- III.** Vendimi mbi Njoftimin për Autorizimin Preliminar nuk i jep të drejtë bartësit që të fillojë ndërtimin e stabilimenteve të reja gjeneruese para se t’i plotësojë të gjitha kushtet dhe kërkesat e përcaktuara në pikën II. të këtij Vendimi.
- IV.** Vendimi mbi njoftimin për autorizimin preliminar, i lëshohet ndërmarrjes “Drini i Bardhë” SH.A., për dy (2) vite, dhe obligohet që brenda kësaj periudhe të bëjë kërkesë me shkrim duke kërkuar që ti lëshohet Autorizimi për ndërtim të stabilimenteve të reja gjenerues nga Uji.



## Arsyetim

- ZRRE me datë 14.03.2012 nga ndërmarrja **“Drini i Bardhë” SHA.**, ka pranuar aplikacionin për marrjen e autorizimit për ndërtim të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhim të energjisë elektrike nga uji, , në Lumin Drini i Bardhë, të tipit digë, me kapacitet të instaluar prej 9.9 MW, në lokacionin e fshatit Dobrushtë, komuna e Prizrenit.
  - ZRRE, pas vlerësimit të dëshmive të bashkangjitura aplikacionit dhe pranimi të dëshmive tjera plotësuese, të kërkuara nga ZRRE, dhe duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.
- V.** Vendim nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- VI.** Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

**Këshillë juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.

### Bordi i ZRRE-së

---

Enver Halimi, kryesues

---

Përparim Kabashi, anëtar

---

Blerim Koci, anëtar

---

Merita Kostari, anëtare

---

Krenar Bujupi, anëtar